

RREGULLORE E UNIVERSITETIT "JUSTINIANI I"

KREU I

PARIME TE PERGJITHSHME

Neni 1

Rregullorja e Universitetit "JUSTINIANI I" mbështetet ne Ligjin Nr. 8461, date 25.02.1999, i ndryshuar, "Per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise", vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.156, date 22.3.2001, "Per shkollat Private ne Republiken e Shqiperise", lejen e posacme te dhene me Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. date dhe ne Statutin e kesaj shkolle.

Neni 2

Kjo Rregullore i bashkengjitet Statutit te Universitetit "JUSTINIANI I" dhe e shtrin veprimin mbi gjithe njesite perberese te kesaj shkolle.

KREU II

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Neni 3

Univeristet JUSTINIANI I eshte shkolle e nivelit universitar dhe pasuniversitar, e cila perbehet nga dy fakultete, Fakulteti i Drejtesise dhe Fakulteti i se Drejtes Nderkombetare dhe Diplomaci

Ne perberje te kesaj shkolle perfshihen :

REKTORATI

a) autoritetet drejtuese te shkolles se larte;

1. Rektori
2. Senati

FAKULTETET

a) autoritetet drejtuese :

1. Dekani
2. Zevendesdekani

3. Kancelari
4. Keshilli Shkencor

b) njesite baze te punes mesimore shkencore:

1. Departamenti i te drejtes publiko-nderkombetare
2. Departamenti i te drejtes civile
3. Departamenti i te drejtes penale

c) administrata

KREU III

AUTORITETET DREJTUESE TE SHKOLLES

Neni 4

Rektori dhe Senati

Rektori eshte organ monokratik, autoriteti me i larte i Universitetit "JUSTINIANI I". Kompetencat e tij jane percaktuar ne Statutin e kesaj shkolle.

Senati eshte organ kolegjal dhe epror i Shkolles se Larte Private Universitare "JUSTINIANI I". Kompetencat e tij jane percaktuar ne Statutin e kesaj shkolle.

Neni 5

Dekani dhe Keshilli Shkencor

Dekani eshte autoriteti me i Larte i Fakultetit. Kompetencat e tij jane percaktuar ne Statutin e kesaj shkolle

Keshilli shkencor eshte organi kolegjal me i larte ne Fakultete. Kompetencat e tij jane percaktuar ne Statutin e kesaj shkolle.

Neni 6

Zevendesdekani

Drejton, organizon dhe kontrollon punen mesimore shkencore. Ndjek zbatimin e planeve dhe te programeve mesimore. Harton planin kalendarik te procesit mesimor.

Harton orarin e mesimeve e te provimeve dhe ndjek zbatimin e tij.

Ndjek plotesimin korrekt te dokumentacionit shkollor nga sekretaria mesimore, te cilen e ka ne varesi te drejtperdrejte.

Neni 7

Kancelari

Kancelari është specialist me formim të lartë ekonomik e financiar ose juridik dhe me përvojë të lartë organizuese.

Kancelari menaxhon veprimtarinë ekonomike, financiare e administrative të fakultetit. Ai organizon kontroll revizionin e brendshëm dhe bën analizë me karakter ekonomik financiar të cilat ia paraqet dekanit për shqyrtim.

Kancelari përgjigjet për arketimin e kuotave të studenteve, si dhe për shlyerjen e detyrimeve të fakultetit ndaj organeve shtetërore, për pagimin e taksave, tatimeve, si dhe për detyrimet ndaj të tjerëve.

Neni 8

Përgjegjësi i departamentit

Përgjegjësi i departamentit është autoriteti më i lartë për njësinë baze mesimore shkencore.

Kompetencat e tij janë :

- a) drejton punën për hartimin e planeve dhe programeve mesimore për lëndët që mbulon departamenti dhe ndjek zbatimin e tyre;
- b) drejton punën për hartimin e teksteve mesimore për lëndët që mbulon departamenti;
- c) drejton punën shkencore në fushat që mbulon departamenti;
- d) bën analizë të punës mesimore shkencore në departament dhe propozon masa për përmirësimin e mëtejshëm të saj;
- e) drejton komisionin që për zgjedh personelin akademik me konkurs dhe i propozon dekanatit emelimin e tyre;
- f) i propozon dekanatit masa për shkëlqje të disiplineve të punës nga personeli akademik

Neni 9

Personeli akademik

Pedagoget e brendshëm e të jashtëm përzgjidhen me konkurs. Kriteret e konkursit propozohen nga departamenti përkatës dhe miratohen nga dekani.

Për zhvillimin e konkursit ngrihet një komision i përbërë nga pedagogë me përvojë të departamentit, nga përfaqësues të dekanatit dhe të rektoratit.

Kandidati i përzgjedhur merret fillimisht me kontratë pune 6 muajore deri në një vjeçar; kontrata nënshkruhet nga dekani dhe i punësuarit; .

Pas përfundimit të kontratës dhe plotësimit të kushteve të saj, punonjësit me gradë shkencore mund të lidhin kontratë pune definitive.

Pedagoget pa gradë shkencore mund të punësohen vetëm me kontratë me afatë të caktuara jo më shumë se një vit, të përsëritshme.

Pedagoget e huaj pranohen në baze të marrëveshjeve dypalëshe.

KREU III

PRANIMI I STUDENTEVE

Neni 10

Pranohen per t'u regjistruar pranë Universitetit "Justiniani I" shtetasit shqiptarë ose te huaj qe plotesojne keto kushte:

Vertetojne me dokument zyrtar mbarimin e shkolles se mesme ne Shqiperi ose jashte shtetit (ekuivalentuar sipas kriterëve te percaktuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkences).

Vërtetojnë me dokumente zyrtare transferimin nga nje institucion i arsimit të lartë publik ose privat që ushtron veprimtarinë e tij në Shqipëri ose jashtë shtetit.

Pranojne pagimin e tarifës se caktuar mujore ose vjetore

Neni 11

Perzgjedhja e kandidateve behet nga nje komision i caktuar nga dekanati mbeshtetur ne dokumentacionin e paraqitur si dhe nepermjet intervistes.

Numri i pranimeve bazohet ne mundesite reale te fakultetit per nje mesim normal dhe brenda standarteve te kerkuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkences.

KREU IV

STUDIMET UNIVERSITARE

Neni 12

Afati i studimeve

Afati i studimeve ne Fakultetin e Drejtesise eshte:

DNP ne drejtesi	3 vjet
DND ne Juridik	2 vjet
MNP jurist i pergjithshem	1 vit
MND ne shkencat penale	2 vjet (tre semestra)
Dr ne shkencat juridike	3 vjet

Afati i studimeve ne Fakultetin e se Drejtes Nderkombetare dhe Diplomaci eshte:

DNP ne te Drejtes Nderkombetare dhe Diplomaci 3 vjet

Neni 13

Afati maksimal i studimeve

Afati maksimal i perfundimit te studimeve eshte 10 vjet.

Studentet, qe nuk arrijne t'i perfundojne studimet brenda ketij afati maksimal, humbasin te drejten e vazhdimet te studimeve.

Te drejten e vazhdimet te studimeve e humbasin edhe studentet, te cilet shpallen tri here perserites per te njejtin vit.

Afati maksimal i mbrojtjes se diplomes eshte deri ne 3 vjet nga koha e e mbarimit te studimeve te plota. Brenda ketij afati, studenti ka te drejte te provohet per mbrojtje diplome deri ne kater here.

Neni 14

Nderprerja dhe rifillimi i studimeve

Studenti mund t'i nderprese studimet ne cdo kohe te vitit per arsye personale per nje afat jo me teper se tri vjet dhe mund t'i rifilloje ato duke respektuar afatet maksimale te parashikuara nga neni 11.

Studenti nuk detyrohet te paguaje tarifen e shkollimit per periudhen e nderprerjes se studimeve.

Ne cdo rast studenti eshte i detyruar te njoftoje dekanatin per nderprerjen dhe rifillimin e studimeve.

Studenti mund t'i rifilloje studimet ne ate periudhe te vitit akademik, ku i ka nderprere, ne fillim te simestrit ose te vitit shkollor.

Neni 15

Mesimi

Format e punes mesimore jane leksionet, seminaret, ushtrimet, punet laboratorike, praktikat profesionale, detyrat e kursit, provimet e kursit dhe provimet e formimit.

Neni 16

Kursi dhe grupi

Mesimi zhvillohet ne baze kursi ose grupi.

Leksionet zhvillohen ne baze kursi deri ne 100 studente, seminaret ne grupe jo me teper se 25 studente; punet laboratorike dhe praktikat profesionale ne grupe me te vegjel.

Neni 17

Regjistri

Ndarja e studenteve ne grupe shenohet ne regjistra qysh ne fillim te vitit akademik. Regjistri i grupit eshte dokumenti zyrtar qe evidenton dhe verteton zhvillimin e ores se mesimit nga pedagoget e brendshem dhe te jashtem.

Neni 18

Frekuentimi

Leksionet, si rregull, jane me frekuentim fakultativ. Seminaret, punet laboratorike dhe praktikat profesionale detyrueshme per vazhdimin e shkolles, te pakten 75 per qind. Provimet jane te detyrueshme per te gjithet.

Neni 19

Orari i mesimit

Koha dhe auditori i zhvillimit te mesimit pasqyrohet ne orarin e shpallur nga sekretaria mesimore. Orari eshte i detyrueshem per studentet dhe pedagoget e brendshem dhe te jashtem. Orari ndertohet mbi kritere pedagogjike, duke e shperndare ngarkesen mesimore ne menyre te balancuar.

Neni 20

Ora mesimore

Ora mesimore (akademike) zgjat 60 minuta.

Neni 21

Sistemi i notave

Shkalla e pervesimit te dijeve behet me sistemin prej dhjete notash. Notat nga pese e lart jane kaluese. Ne format e kontrollit me shkrim perdoret sistemi i vleresimit me pike, rezultati kthehet detyrimisht ne note.

KREU V

PROVIMET

Neni 22

Menyra e provimit

Kontrolli i dijes se nje lende (provimi) behet me shkrim ose me goje. Ne cdo rast dijet e studentit kontrollohen nepermjet kontaktit te drejtperdrejte te pedagogut me studentin ne formen e bashkebesedimit.

Menyrat konkrete te kontrollit percaktohen nga departamenti perkates, mbeshetur ne planin mesimor dhe me miratimin e dekanatit.

Tezat e provimit, ne te gjitha rastet e kontrollit, formulohen nga titullari i lendes dhe miratohen nga pergjegjesi i departamentit. Ne formulimin e tezave behen perpjekje maksimale per harmonizimin e dijeve teorike me shprehite praktike te studentit.

Neni 23

Studenti fiton te drejten te futet ne provimin e nje lende, kur ka shlyer detyrimet vjetore qe lidhen me ate lende, te parashikuara ne planin mesimor.

Studentet qe fitojne te drejten e dhenies se provimit regjistrohen ne fleten e provimit. Ajo plotesohet nga sekretaria mesimore, nenshkruset nga dekani ose Zv.Dekani dhe kryesekretarja dhe mban vulen e fakultetit. Fleta e provimit i dorezohet komisionit te provimit dite e provimit. Me perfundimin e provimit, kryetari i komisionit e dorezon te mbushur ne sekretari.

Fleta e provimit nuk duhet te kete korigjime: ajo perben dokumentin zyrtar qe verteton dhenien e provimit dhe rezultatin e studentit.

Neni 24

Provimet dhe riprovimet zhvillohen brenda afatit te caktuar ne strukturen e vitit akademik.

Datat e provimeve shpallen jo me vone se dy jave para fillimit te sesionit.

Neni 25

Studentet merren ne provimin e kursit nga titullari i lendes dhe asistenti tij te cilet kane zhvilluar lenden.

Ndalohet hyrja ne provim e personave te jashtem, qofshin edhe anetare te personelit, me perjashtim te personave te caktuar nga autoritetet universitare per kontroll.

Neni 26

Studenti nuk lejohet te hyje ne provimin e nje lende per te dyten here brenda nje sesioni. Studenti nuk mund te hyje ne dy provime ne te njejten dite.

Studenti paraqitet ne provim me librezen e studentit ku shenohet nota e fituar .

Neni 27

Studenti ka te drejte te jape ne sesionin e vjeshtes (riprovime) nje numer provimesh, numer i cili percaktohet sipas vendimit te Dekanatit ne perputhje me planin mesimor. Studenti eshte i detyruar te shlyeje ne fillim detyrimet e mbartura dhe pastaj detyrimet e vitit ne vazhdim.

KREU VI

PRAKTIKAT PROFESIONALE

Neni 28

Studenti eshte detyruar te ndjeke praktikat profesionale te parashikuara ne planin mesimor. Studenti qe nuk realizon praktikat profesionale, u nenshtrohet rregullave te vendosura si per te gjitha detyrimet e tjera.

Neni 29

Praktikat profesionale zhvillohen ne institucionet e caktuara nga dekanati dhe nen drejtimin e pedagogut te caktuar nga fakulteti. Praktikate profesionale vleresohen me nota, njelloj si detyrimet e tjera. Studenti detyrohet te respektoj rregullat e institucionit ku kryhen praktikate profesionale.

KREU VII

TRANSFERIMET E STUDENTEVE

Neni 30

Universiteti "JUSTINIANI I" pranon transferime te studenteve ne vitet ndermjetese nga shkollat e tjera universitare, vendase ose te huaja, publike ose Private dhe lejon transferimin e studenteve te saj ne shkollat e tjera, sipas procedurave te parashikuara ne kete rregullore.

Neni 31

Studenti qe deshiron te transferohet nga nje Universitet tjeter Universitetin "JUSTINIANI I" duhet t'i paraqese nje kerkese Rektorit ku te parashtroje arsyet e transferimit.

Se bashku me kerkesen duhet te paraqese nje kopje te diplomes se shkolles se mesme (te noterizuar), detyrimet e shlyera ne shkollen derguese me notat perkatese, nje kopje te programeve te lendeve te shlyera, certifikaten e lindjes me fotografi, nje karakteristike me te dhena te hollesishme mbi sjelljet dhe rezultatet e kerkuesit nga universiteti dergues.

Nelli 32

Dokumentacioni i percillet Fakultetit perkates, i cili ben vleresimin e lendeve sipas programeve te tij mesimore, percakton kursin ku duhet te vazhdoje aplikanti dhe provimet plotesuese.

Dekanati, pasi shqyrton dokumentacionin, njofton kerkuesin per pranimin e kerkeses dhe urdheron regjistrimin e tij.

Ne cdo rast kerkuesi duhet te pranoje pagimin e tarifes nga dita e regjistrimit.

KREU VIII

DIPLOMIMI

Neni 33

Ne perfundim te kursit te plote te studimeve, studentet kane te drejte te diplomohen per te fituar titullin perkates.

Diplomimi behet me provim formimi profesional.

Me përfundimin e programit të studimeve të ciklit të parë, studenti fiton Diplomën e Nivelit të Parë DNP në programin e studimit qe ai ka zgjedhur.

Me përfundimin e programit të studimeve të ciklit të dytë, studenti fiton Diplomën e Nivelit të Dytë DND në specialitetin që ai ka zgjedhur gjatë aplikimit, ose Master te Nivelit te Pare MNP.

Me përfundimin e programit të studimeve të ciklit të trete, studenti fiton Diplomën e Masterit te Nivelit te Dyte MND dhe ate te Doktoratures.

Brenda nje muaji nga data e fillimit te vitit akademik dekanati u ben te njohur studenteve te vitit te fundit programin e provimit te formimit.

Neni 34

Provimi i formimit organizohet ne dy sesione: i veres dhe i dimrit, te cilet percaktohen nga dekani i fakultetit.

Studenti qe rrezohet ne sesionin e pare te provimit te formimit ka te drejte te paraqitet per mbrojtje ne sesionin e ardhshem.

Neni 35

Studenti qe ka plotesuar te gjitha kerkesat e planit mesimor dhe ka dhene provimin e formimit, pajiset nga universiteti me diplomen perkatese, te shoqeruar me suplement Diplomen e parashikuar ne udhezimin e MASH.

Diploma plotesohet me shkrim te qarte e me boje teknike dhe nenshkruhet nga kryetari i komisionit te provimeve te formimit, Dekani i Fakultetit dhe Kryesekretari. Per secilin prej tyre shenohet emri, mbiemri, grada dhe titulli shkencor. Nenshkrimet e tyre vertetohen me vulen e Universitetit "JUSTINIANI I".

Nelli 36

Dorezimi i diplomave behet me ceremoni. Per studentet qe kane perfunduar studimet me te gjitha notat dhjeta, jepet certifikata "Medalje e arte". Per studentet qe kane perfunduar studimet me mbi 80 per qind te notave dhjeta dhe pjesen tjeter vetem nenta jepet certifikata "Student i shkelqyer".

Neni 37

Terheqja e diplomes behet personalisht nga i diplomuari, kundrejt nenshkrimit dhe evidentohet ne regjistrin perkates. Ne se prania e te diplomuarit eshte objektivist e pamundur, terheqjen e diplomes mund ta beje nje nga pjestaret e familjes, i pajisur me prokure te posacme duke paraqitur leternjoftimin e tij.

Ne se diploma nuk eshte plotesuar ne rregull, i interesuari duhet te mos e terheqe ate dhe te kerkoje pajisjen me diplome te rregullt. Nese i interesuari e terheq diplomen e parregullt, ne rast se i humbet origjinali ose demtohet, duke u bere i paperdorshem, shkolla nuk leshon dublikate. Lejohet vetem dhenia e listes se notave te fituara dhe vertetimi me fotografi, i cili eshte ekuivalent me diplomen, pasi nenshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Kryesekretari i tij. Nenshkrimet e tyre vertetohen me vulen e Universitetit "JUSTINIANI I".

KREU IX

TE DREJTAT DHE DETYRAT E STUDENTIT

Neni 38

Studenti ka te drejte :

- a) te perfitoje nga procesi mesimor dhe te diplomohet pasi te shlyeje te gjitha detyrimet e percaktuara ne planin mesimor;
- b) te perdore mjediset e shkolles per realizimin e programit mesimor;
- c) te organizohet ne shoqata studentore jopolitike, sipas percaktimeve te akteve ligjore perkatese;
- d) te marre pjese ne veprimtari artistike, kulturore, sportive, argetuese te organizuara nga shkolla jashte procesit mesimor,
- e) te ndikoje ne permiresimin e procesit mesimor nepermjet formave demokratike te shfaqjes se vullnetit;
- f) te degjohet nga organizmat perkatese, para se te merret ndonje mase ndeshkuese kunder tij;

Neni 39

Studenti ka te drejte te permiresoje cdo vit mesimor vetem nje note ne sesionin e riprovimeve (vjeshte). Kerkesa i paraqitet dekanatit para sesionit te riprovimeve.

Studenti qe kerkon permiresimin e notes provohet vetem nje here; pas kesaj mbetet ne fuqi nota me te cilen vleresohet ne fund.

Neni 40

Studenti eshte i detyruar:

- a) te njohet me hollesi rregullat e shkolles dhe detyrimet e tij. Shkolla nuk mban pergjegjesi per pasojat qe mund te rrjedhin nga mosnjohja e tyre;
- b) te zbatohet te gjitha rregullat qe rrjedhin nga Statuti dhe Rregullorja e shkolles, si dhe nga cdo akt tjeter ligjor dhe nenligjor per arsimin e larte.
- c) te shlyeje te gjitha detyrimet e percaktuara ne planin mesimor dhe ne programet e lendeve;
- d) te mbaje pergjegjesi per shkeljet e rregullave te shkolles; ne rast se ka shkaktuar nje dem material, detyrohet ta zhdemtojte ne masen qe e gjykon dekanati;
- e) te paguaje rregullisht tarifen e shkollimit.

Neni 41

Shkelje te rregullave te shkolles konsiderohen te gjitha veprimet e kryera me dashje nga studenti qe perbejne cenim te normave shoqerore etiko-morale, kur nuk permbajne elemente te vepres penale, sidomos cenimi i dinjitetit te mesimdhenesit dhe te cdo punonjesi te shkolles, kopjimi ne provime, falsifikimi i dokumenteve, aktet e rrugacerise, dhenia e mites, vjedhje te vogla etj.

Ndaj studentit qe kryen veprime te tilla merren keto masa disiplinore

- a) verejtje me shkrim;
- b) perjashtim per nje vit nga shkolla ;
- c) perjashtim pergjithmone nga shkolla.

Vendimet e mesiperme i merr dekanati dhe Zv. Dekani.

Neni 42

Te drejtat dhe detyrat e pedagogut percaktohen ne kontraten e punes.

Neni 43

Kompetencat qe do te kete grupi i sistemit te brendshem te sigurimit te cilesise do te jene:

Vleresimi periodik i programeve te studimit dhe stafit te perfshire ne te .

Vleresimi i programeve te reja qe do te hapen ne universitet dhe dhenia nje mendimi te detajuar senatit te Univeristetit .Transparenca ne vleresim e kryer dhe berja publike (aq sa do te lejohet nga administratori).Berja e nje raporti vjetor ne rektorat dhe senat dhe duhet pare Impakti i ketij raporti. Evitimi sa te jete i mundur nga nderhyrja ne sistem e Drejtueseve te Institucionit. Anetarsimi ne grup i nje eksperti te jashtem (mundesisht nga tregu i punes)dhe e nje studenti si anetar i grupit te Sistemi i Brendshem i Sigurimit te Cilesise SBSC ne cdo hallke te ketij sistemi .

Sistemi i Brendshem i Sigurimit te Cilesise do ti nenshtrohet auditimit nga administratori i Institucionit .

Neni 44

Te drejten e interpretimit te rregullores e ka Rektori i Universitetit ,
Miratuar me vendim te Senatit te Universitetit "JUSTINIANI I",

Rektori
Prof.Dr. Ismet ELEZI

Tirane me 30.09.2008